

Garanci e Limituar e Aksesorit

Shitesi i aksesorit ("Aksesori") BlackBerry Wireless Handheld, Research in Motion Limited ("RIM") qe eshte prodhuesi dhe përfaqësuesit të tij, Research in Motion UK Limited, me Nr. rregjistrimi 4022422, me seli në adresën: Centrum House, 36 Station Road, Egham, Surrey, UK, TW20 9LF, u garanton JU, përdoruesin ("JU"), që Aksesori nuk do te kete defekte materiale dhe gjate perdorimit për një periudhë jo më shume se (a) 1 (një) vit nga dita kur Aksesori u ble së pari nga Ju si përdoruesin e vetem (b) dhe perfundon: (1) me shkeljen e marreveshjes nga ana juaj ose mbarimin e afatit te Marrëveshjes së Licensës të Software-t për përdoruesin ("Marrëveshje për license") lidhur midis JU-sh dhe RIM, ose (2) me shkeljen (i) e marreveshjes per garancine e limituar, (ii) Garancia e limituar e dhene me BlackBerry Handheld, (iii) cdo Garancie e limituar e dhene me cdo aksesore BlackBerry ose bateri te jashme, ose (iv) Rregullave teknike të dhëna me Aksesorin dhe /ose me BlackBerry Handheld, ("Periudha e Garancisë"). Kjo garanci e limituar nuk eshte e transferueshme. Gjatë periudhës së Garancisë, Aksesori do të riparohet dhe zëvendësohet sipas zgjedhjes se RIM pa pagesë si për pjesët dhe për punën e kryer. Nëse aksesori është riparuar ose zëvendësuar gjatë periudhës se garancisë, periudha e Garancisë do përfundoj jo më vonë se 91 ditë pas riparimit apo zëvendësimit ose një (1) vit nga dita e blerjes fillestare. Bazuar në marrëveshjen midis RIM dhe rishitësit ose distributorit nëpërmjet të cilit ju keni blerë Aksesorin dhe/ose BlackBerry Solution ("RIM Solution Provider"), kjo Garanci e Limituar gjatë Periudhës së Garancisë do të respektohet ose nga RIM ose Furnizuesi RIM Solution. Kjo garanci e limituar nuk aplikohet gjatë prishjes dhe carjes normale, ose nëse Aksesori ose ndonjë komponent prej saj është hapur ose riparuar nga dikush jo i autorizuar nga RIM, dhe nuk mbulon riparimin ose zëvendësimin e ndonjë Aksesori të dëmtuar nga: shpërdorimi, lagështia ose lëngjet, afërsia dhe ekspozimi ndaj nxehtësisë, aksidente, abuzime, neglizhencë, keqpërdorim, ose defekteve për shkak të riparimeve ose modifikimeve të bëra jo nga persona të RIM. Kjo Garanci e Limituar nuk mbulon dëmtimin fizik të sipërfaqes së Aksesorit. Kjo Garanci e Limituar përvec Aksesorit nuk aplikohet për pajisje të tjera. Garancia e Limituar gjithashtu nuk aplikohet nëse keqfunksionimi vjen si rezultat i përdorimit të Aksesorit me aksesore, produkte, shërbime ose pajisje periferike ose të varura jo të aprovuara shprehimisht apo parashikuara nga RIM, dhe ku është përcaktuar nga RIM që ky keqfunksionim nuk është për faj të Aksesorit. Përvec kësaj, nëse keqfunksionimi vjen si rezultat i gabimit të përdoruesit për mosveprim në përputhje me Rregullat Teknike të shoqëruara me Aksesorin ose me cdo komponent të BlackBerry Solution, që përfshin BlackBerry Handheld, cdo aksesore BlackBerry, duke përfshirë bateri te jashtme dhe Karta Sim, BlackBerry Desktop Software dhe shërbimin e transmetimit të të dhënave të lidhura pa kabëll dhe dokumentacionin ("BlackBerry Solution"), Garancia e limituar mund të jetë e pavlefshme dhe nëse është e pavlefshme nuk do mund të aplikohet. **Ju lutemi, konsultohuni me dokumentacioni shoqerues te Aksesorit per udhëzime se si te perfitoni asistencen e klientit per Aksesorin Tuaj.**

RIPARIMI OSE ZËVENDËSIMI I AKSESORIT ASHTU SIC ESHTË PARASHIKUAR KETU ESHTË MËNYRA E VETME E KOMPESIMIT TE DHENE PËR JU. KJO GARANCI E LIMITUAR ËSHTË NË VEND TË TË GJITHA PËRFAQËSIMEVE, GARANCIVE, VËRTETIMEVE OSE KUSHTEVE, TË SHPREHURA APO TË NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRË POR JO DUKE U KUFIZUAR TE PËRFAQËSIMI, GARANCIA, VËRTETIMI OSE KUSHTI TREGTAR, CILËSIA E SHITJES, CILËSIA E KËNAQSHME, PËRSHTATJA PËR NJË PËRDORIM TË VECANTË OSE QËLLIM, TITULL, MOSSHKELJE, OSE QË MUND TË RRJEDHIN NGA RREGULLA OSE ZAKONE OSE RRJEDHJA E MARRËVESHJEVE OSE QËLLIMI TREGTAR. AS RIM DHE AS NJË FURNIZUES I RIM SOLUTION NUK DO TË JENË NË ASNJË MËNYRË PËRGJEGJËS NDAJ JUSH DHE JU NË KËTË MËNYRË HIONI DORË NGA CDO DËMTIM INDIREKT, EKONOMIK, TREGTAR, TË RASTËSISHËM, TIPIK APO QË RRJEDH DREJTËPËRSËDREJTI (DUKE PËRFSHIRË PA LIMIT FITIME TË HUMBURA, HUMBJE E TË ARDHURAVE TË BIZNESIT OSE FITIMEVE, HUMBJA E TË DHENAVE, DËME TË SHKAKTUARA NGA VONESA OSE NGA DËSHTIMI PËR TË REALIZUAR KURSIME E PRITURA), QË VIJNË SI REZULTAT I PËRDORIMIT OSE FUNSIONIMIT TË AKSESORIT, MADJE EDHE NËSE RIM APO FURNIZUESI RIM SOLUTION JANË NË DIJENI TË MUNDËSISË SË KËTYRE DËMTIMEVE. KY KUFIZIM KA PËR QËLLIM TË APLIKOHET DHE DO APLIKOHET PA MARR PARASYSH NËSE KËTO DËMTIME JANË KERKUAR, SHPALLUR APO ËSHTË NGRITUR PADI, PADI PËR ZHDËMTIMIN E DËMIT (DUKE PËRFSHIRË EDHE NEGLIZHENCËN) APO TE PËRFSHIRË NË KONTRATE, OSE NËN GARANCI, OSE NËN NDONJË LIGJ TJETËR OSE FORME PADIE. NË ASNJË MËNYRË RIM NUK DO TË JETË PËRGJEGJËS NDAJ JUSH APO NDONJË PALE TË TRETË E CILA NËPËRMJET JUSH OSE NË EMËR TUAJ PRETENDON TË RRIS CMIMIN E BLERJES SË AKSESORIT OSE KOSTON E RIPARIMIT APO ZËVENDËSIMIT TË AKSESORIT, E CILA ËSHTË E MADHE. PËR SHMANGJEN E CDO DYSHIMI ASNJE E PERMENDUR KETU NUK DO TË PËRJASHTOJ OSE KUFIZOJ PËRGJEGJËSINË E RIM OSE TË CDO FURNIZUESI RIM SOLUTION PËR VDEKJEN APO DËMTIMIN

PERSONAL TË SHKAKTUAR PËR NEGLIZHENCË TË RIM, PUNONJESVE TË TIJ OSE AGJENTËVE OSE TË FURNIZUESIT RIM SOLUTION.

GARANCIA E LIMITUAR JU JEP TË DREJTA SPECIFIKE LIGJORE, DHE JU MUND TË KENI TË DREJTA TË TJERA QË VARIOJNË NGA NJË VEND NË TJETRIN. DISA VENDE MUND TË MOS LEJOJNË PËRJASHTIMIN APO KUFIZIMIN E DËMTIMEVE TË RASTËSISHME APO TË DREJTËPËRDREJTA, MUND TË MOS LEJOJNE KUFIZIME PER SA KOHË NJË GARANCI E NËNKUPTUAR APO KUSHT ZGJAT OSE PARASHIKOJNE KUSHTE QË LEJOJNË QË GARANCIA TË JETË E PAVLEFSHME. KESHTU QE, DISA PREJ KUFIZIMEVE APO PËRJASHTIMEVE TË MËSIPËRME MUND TË MOS APLIKOHEN TEK JU. TË DREJTAT TUAJA TË DETYRUESHME SI KONSUMATOR NUK DO TE PREKEN PËR SA KOHË QE JU MUND TË KENI TË DREJTA TË TILLA TË DETYRUESHME.

Heqja dorë nga RIM për mospërbushje detyrimesh nuk do të konsiderohet një heqje dore në vazhdim nga kjo mospërbushje ose nga cdo mospërbushje tjetër.

Garancia e limituar do zbatohet nga dhe në përputhje me ligjet e Anglisë dhe Uellsit, me përjashtim të rasteve kur ka konflikte ligjesh. Palët në këtë Garanci të Limituar ("Palët" sëbashku dhe një "Palë" në vecanti) ranë dakort që Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për shitjet ndërkombëtare të mallrave është e paaplikueshme ne teresine e saj ne këtë Garanci të Limituar. Të gjitha mosmarrëveshjet dhe konfliktet që lindin nga ose ne lidhje me këtë Garanci të Limituar do të zgjidhen nga arbitrazhi. Vendimi i arbitrit do jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët (vetem neqoftese është dukshëm i gabuar). Vendimi i arbitrit do jetë ne forme te shkruar dhe do te kete dispozitiv. Vendimi i arbitrit duhet të përmbajë koston e arbitrimit që do të paguhet nga palët në atë masë që arbitri e mendon te arsyeshme. Vetem neqoftese është e ndaluar nga legjislacioni vendas, arbitrazhi do të: (i) mbahet në Londër, Angli; (ii) nën legjislacionin anglez, (iii) në gjuhën angleze; në bazë të rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë ("Rregulla"); dhe (v) çështja do dëgjohet nga një arbitër i caktuar në përputhje me rregullat e lartpërmendura, i cili do pranohet reciprokisht nga Palët brenda 30 ditëve nga dita e caktimit të arbitrit. Në rast dështimi të marrëveshjes arbitri do të emërohet nga Presidenti i Shoqërisë Britanike të Kompjuterave në momentin e kërkesës për arbitrazh (ose nga një person i ngarkuar me detyrë nga presidenti për të vepruar në emër të tij) në bazë të aplikimit të cdo Pale. Nëse dispozitat e fjalisë së mësipërme janë në kundërshtim me ligjin vendas, arbitrazhi do të: (i) mbahet në Tiranë, Shqipëri; (ii) në gjuhën angleze; (iii) çështja do kalojë në arbitrazh ne përputhje me Rregullat e Arbitrazhit dhe procedurat e Qendrës MEDART ("Rregullat MEDART"); dhe (iv) çështja do dëgjohet nga një arbitër në përputhje me Rregullat e Medart dhe do pranohet reciprokisht nga Palët brenda 30 ditësh nga dita e caktimit të arbitrit, dhe në rast dështimi të marrëveshjes Qendra MEDART do të caktoj arbitrin. Asnjë konflikt midis Palëve, ose që përfshin cdo person vec Ju, nuk mund të bashkohet ose kombinohet së bashku, pa aprovimin paraprak me shkrim të RIM.

Nëse një klauzolë e Garancisë së Limituar është e paligjshme ose jo e detyrueshme, nuk do të thotë që do të shfuqëzohet ose do bëjë të pa detyrueshme të tërë Garancinë e limituar, por për më tepër Garancia e limituar do të interpretohet sikur nuk përmban klauzola të pavlefshme ose te padetyrueshme dhe të drejtat dhe detyrimet të secilës Palë do të interpretohen dhe zbatohen në përputhje me rrethanat.

Nëse Garancia e Limituar është përkthyer në një gjuhë të ndryshme nga anglishtja, versioni anglisht do të mbizotërojë në rast se do ketë ndonjë konflikt apo mospërputhje në kuptim midis versionit anglisht dhe ndonjë përkthimi prej saj.

Nëse do ketë ndonjë mospërputhje midis Garancisë së Limituar dhe cdo garancie tjetër të përfshirë në paketimin e Aksesorit, klauzolat e Garancisë së Limituar do të aplikohen për sa kohë do jetë kjo mospërputhje.

Vini re: Ky aksesor ka për qëllim të përdoret vetëm së bashku me BlackBerry Handheld. Ju lutem konsultoni Instalimin Tuaj dhe Guiden Te Fillojme ose Guiden te Fillojme instalimin për të përcaktuar në se Aksesori përputhet me BlackBerry Handheld. Cdo përdorim tjetër do të bëjë këtë Garanci të Limituar të pavlefshme, dhe RIM nuk do jetë në asnjë mënyrë përgjegjës për JU ose ndonjë palë të tretë për cdo dëmtim që Ju ose cdo palë e tretë mund të pësojë si rezultat i përdorimit të këtij Aksesori së bashku me ndonjë pajisje apo aksesorë të ndryshëm nga Blackberry Handheld.

E drejta e autorit – 2006 Research in Motion Limited. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Të gjitha markat, imazhet dhe simbolet e lidhura me familjet e Blackberry dhe RIM janë pronë ekskluzive e Research In Motion Limited. Simbolet e

RIM, Research In Motion, 'Always On, Always Connected', "envelope in motion" dhe simboli i BlackBerry janë regjistruar ne zyrat e Kombeve te Bashkuara per Patentat dhe Markat mund të jenë në pritje ose të regjistruar në vende të tjera. Të gjithë market e tjera, emrat e produkteve, emrat e kompanive, markat tregtare dhe markat e shërbimit janë pronë e pronarëve përkatës. Pajisje që mbahen në dorë dhe/ose programet shoqëruese janë të mbrojtura nga e drejta e autorit, marrëveshjet ndërkombëtare dhe patenta të ndryshme duke përfshirë një ose disa nga patentat e Kombeve te Bashkuara si vijon: 6,278,442; 6,271,605; 6,219,694; 6,075,470; 6,073,318; D,445,428; D,433,460; D,416,256. Patentat e tjera janë regjistruar ose janë në proces në vende të ndryshme të botës. Ju lutem vizitoni për të parë listen aktuale te patentave të zbatueshme.